

# FINANCA

Buletini Maja | MAJ 2026



## MINISTRI MALAJ: SHQIPËRIA, PARTNERE AKTIVE NË LUFTËN KUNDËR FINANÇIMIT TË TERRORIZMIT

Ministri i Financave mori pjesë në konferencën e 5-të ndërkombëtare ministrale "No Money for Terror", e cila u mbajt në Paris, Francë, ku shprehu angazhimin e qeverisë shqiptare për të qenë një partner aktive në përpjekjet globale në luftën kundër financimit të

terrorizmit dhe mbrojtjen e integritetit të sistemeve financiare. Ministri tha se Shqipëria është një zë aktiv dhe partner i besueshëm, ndërsa po merr një sërë masash në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat janë në linjë me qasjen dhe standardet ndërkombëtare. Ministri theksoi se vendi po investon në rritjen e kapaciteteve institucionale, në modernizimin e sistemeve të monitorimit financiar dhe forcimin e analizës së inteligjencës financiare, sikurse po zgjeron ekspertizën profesionale në fusha të reja si krypto-asetet apo dhe financat digjitale.

LEXO MË SHUMË

## SHQIPËRIA PËRMIRËSON RENDITJEN PËR TRANSPARENCËN E SHPENZIMEVE TATIMORE SIPAS GTETI 2026

Shqipëria ka përmirësuar pozicionimin e saj në renditjen e Global Tax Expenditures Transparency Index – GTETI v.2.1, një indeks ndërkombëtar që synon të masë nivelin e transparencës dhe cilësinë e raportimit të shpenzimeve tatimore në vende të ndryshme. Shqipëria është renditur në vendin e 48-të

sipas këtij Indeksi, ndër 116 vende të përfshira në vlerësim, me 51.73 pikë (nga 100), nga vendi i 74 që renditej më parë, duke konfirmuar progresin e bërë në forcimin e transparencës fiskale dhe përmirësimin e qeverisjes së financave publike. Ky vlerësim ndërkombëtar konfirmon progresin e Shqipërisë në avancimin e transparencës fiskale dhe mbështet objektivin strategjik të afrimit me praktikatat më të mira të vendeve të BE.

LEXO MË SHUMË

## Shqipëria përmirëson ndjeshëm renditjen

01  
02

48 Shqipëria ▲26



## PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS PARAPRAKË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-PRILL 2026

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Prill 2026 reflekton ecurinë e mblendjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Prill 2026, arritën në rreth 275.7 miliardë lekë, 105.2 % e planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u mblodhën rreth 28.8 miliardë lekë ose 11.7 % më shumë. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 4 mujore të vitit 2026, arritën në rreth 221.6 miliardë lekë me një realizim në masën 95.1% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 ky zë ka rezultuar 6.2 % më i lartë ose rreth 12.9 miliardë lekë më shumë.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRI MALAJ, VIZITË NË DEGËN DOGANORE NË PORTIN E DURRËSIT: MASA PËR MENAXHIMIN E FLUKSEVE TURISTIKE DHE FORCIMIN E SIGURISË

Ministri i Financave zhvilloi një vizitë pune në Degën Doganore në Portin e Durrësit, në kuadër të

LEXO MË SHUMË



## TAKIM ME BIZNESE TË TURIZMIT NË DURRËS, MALAJ: POLITIKAT INCENTIVUESE, NË LINJË ME KËRKESAT E BASHKIMIT EUROPIAN

Ministri i Financave zhvilloi një takim me biznese që operojnë në sektorin e turizmit në qytetin e Durrësit. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi problematikat dhe sfidat bizneset hasin gjatë ushtrimit të

masave për menaxhimin e fluksit të sezonit turistik veror dhe lehtësimin e procedurave për qytetarët, turistët dhe operatorët ekonomikë. Ministri i Financave theksoi rëndësinë që ka turizmi për ekonominë shqiptare dhe nevojën për rritjen e standardeve të shërbimit dhe lehtësimin e qarkullimit të turistëve dhe qytetarëve. Gjithashtu, Ministri theksoi se lehtësimi i qarkullimit në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik veror duhet të shkojë paralelisht me forcimin e sigurisë dhe respektimin e ligjit.

LEXO MË SHUMË



## NDRYSHIME NË VKM PËR PULLAT FISKALE, FORCOHET SIGURIA E TYRE DHE RRIHET STANDARDET E SIGURISË USHQIMORE

Ministri i Financave, Petrit Malaj, deklaroi pas mbledhjes së qeverisë se ndryshimet e miratuara në VKM nr.182 për pullat fiskale rrisin elementët e sigurisë dhe parashikojnë aplikimin e teknologjisë "Track & Trace", që mundëson gjurmimin e produkteve të akcizës nga prodhuesi deri te konsumatori final. Një risi me rëndësi është pajisja e pullave të reja fiskale me barkod, përmes të cilit konsumatorët mund të marrin informacion mbi origjinën dhe importuesin e produktit. Ministri theksoi se ndryshimet janë në linjë me standardet e Bashkimit Europian, përmirësojmë administrimit fiskal dhe rrisin shtandardet e sigurisë ushqimore në vend.

LEXO MË SHUMË



## "DYFISHO SIPËRMARRJEN TËNDE", MBËSHTETJE PËR SME-TË PËR RITJEN E AKSESIT NË FINANÇË DHE KONKURRUESHMËRINË E TYRE

Ministri Petrit Malaj mori pjesë në nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Programin Kombëtar të Financimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme "Dyfisho Sipërmarrjen Tënde", një nismë e qeverisë shqiptare në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe sistemin bankar. Malaj theksoi rëndësinë e SME-ve për ekonominë dhe punësimin në vend, duke nënvizuar se programi synon të rrisë aksesin në financë për bizneset në sektorë të nënfinancuar, si dhe të mbështesë investimet në teknologji, dixhitalizim dhe eficiencë energjetike.

LEXO MË SHUMË



## PËRSHPEJTOHET PROCESI I DËMSPËRBLIMIT PËR ISH TË DËNUARIT POLITIKË

Gjatë një deklarate pas mbledhjes së qeverisë, Ministri i Financave informoi se janë miratuar disa ndryshime për

përsheptimin e procesit të dëmspërblimit financiar të ish të dënuarve politikë të regjimit komunist. Sipas ndryshimeve, hiqet kufizimi i pagesës në tetë kështe të barabarta, ndërsa dosjet me vlerë të mbetur deri në 1 milion lekë do të likuidohen brenda kështit të radhës. Malaj theksoi se këto

masa synojnë rritjen e eficiencës së pagesave dhe përbushjen e një detyrimi moral ndaj familjeve të të përndjekurve politikë, ndërsa pritet që procesi i pagesave të përshpejtohet ndjeshëm gjatë viteve në vijim.

LEXO MË SHUMË

## FUQIZIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM, PRIORITET I REFORMËS SË MENAXHIMIT FINANCIAR PUBLIK

Gjatë konferencës me temë "Fuqizimi i Auditit të Brendshëm", Ministri Petrit Malaj theksoi se auditimi i brendshëm mbetet një nga shtyllat kryesore të mirëqeverisjes, transparencës dhe integritetit financiar. Malaj nënvizoi se Ministria e Financave ka ndërmarrë

hapa konkretë për modernizimin e sistemit të auditimit, përmes hartimit të manualit të ri të auditimit të brendshëm, forcimit të certifikimit profesional të audituesve dhe adoptimit të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm. Këto reforma janë të rëndësishme për forcimin e institucioneve publike, përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe avancimin e procesit të integritetit evropian.

LEXO MË SHUMË



## MINISTRI MALAJ: FORMALIZIMI I TURIZMIT, I RËNDËSISHËM PËR GARANTIMIN E KONKURENCËS SË NDRERSHME DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË SEKTORIT

Ministri i Financave zhvilloi një takim me biznese të sektorit të turizmit në qytetin e Vlorës, me fokus diskutimin e problematikave që hasin bizneset gjatë ushtrimit të

aktivitetit të tyre ekonomik dhe zbatimin e Planit Operacional në Turizëm nga Administrata Tatimore. Ministri nënvizoi rëndësinë e formalizimit të aktivitetit turistik, deklarimit korrekt të punonjësve, deklarimit real të pagave dhe zbatimit të faturimit elektronik për garantimin e konkurrencës së ndershme në treg dhe standardeve më të larta të shërbimit. Planit Operacional për sektorin e turizmit synon mbështetjen e bizneseve të ndershme dhe identifikimin e rasteve me risk të lartë, përmes analizës inteligjente dhe teknologjive të avancuara.

LEXO MË SHUMË